

INFORMACION RRETH KURSEVE TË REJA

Duke ndjekur një nga kurset e gjuhës dhe kulturës italiane të Institutit, duke filluar nga niveli A1 deri në C2, do të fitoni aftësitë e mëposhtme të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës së Gjuhëve (CEFR) sipas nivelit të ndjekur:

<p>Niveli i I A1 / A2</p>	<p>A1 – Fillestar: Studenti arrin të kuptojë e të përdorë shprehje familjare të përdorimit të përditshëm dhe formula shumë të zakonshme për të përmbushur nevoja konkrete. Si të prezantojë veten dhe të tjerët. Është në gjendje të drejtojë pyetje mbi situata personale dhe t’u japë përgjigjet analoge (vendi ku banon, njerëzit që njeh, sendet personale). Është në gjendje të komunikojë në mënyrë të thjeshtë në rastet kur bashkëfolësi flet ngadalë, qartë dhe ka dëshirë të bashkëpunojë.</p> <p>A2 – Fillestar i avancuar: Studenti arrin të kuptojë fraza të veçanta dhe shprehje të përdorimit të zakonshëm në situatat të rëndësishme të menjëherëshme (p.sh. informacione të thjeshta për personin dhe familjen, blerje, gjeografi vendore, punësim). Arrin të komunikojë në situata të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë vetëm një shkëmbim të thjeshtë e të drejtpërdrejtë informacionesh familjare dhe të zakonshme. Është në gjendje të përshkruajë me terma të thjeshta pjesë të jetes e të ambientit të tij si edhe elementë që i referohen nevojave të drejtpërdrejta.</p>
<p>Niveli i II B1 / B2</p>	<p>B1 – Mesatar: Studenti arrin të kuptojë pikat kryesore të mesazheve të qarta në gjuhën standarte, mbi argumenta të zakonshme që hasen në ambiente pune, në shkollë, në kohën e lirë, etj. Përballon situata të ndryshme që paraqiten gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet kjo gjuhë. Di të hartojë tekste të thjeshta e koherente mbi argumenta për të familjare, ose që i interesojnë. Është në gjendje të përshkruajë eksperiencë, ngjarje, ëndrra, shpresa, dëshira dhe të paraqesë shkurtimisht arsyjet e tij si edhe të japë shpjegime mbi opinione e projekte.</p> <p>B2 – Mesatar i avancuar: Studenti arrin të kuptojë konceptet bazë në tekste të ndërlikuara si për argumenta abstrakte, ashtu edhe konkrete, përfshirë këtu edhe diskutime teknike të fushës së specializimit personal. Është në gjendje të komunikojë lehtësisht e natyrshëm dhe komunikimi me persona të gjuhës nënë zhvillohet pa shumë vështirësi dhe tension. Di të hartojë tekste të qarta dhe të detajuara mbi një gamë të gjerë tematikash e të shprehë opinionin personal mbi tema aktualiteti, duke paraqitur pro dhe kundra mbi opsionet e ndryshme.</p>
<p>Niveli i III C1 / C2</p>	<p>C1 - I Përparuar: Studenti është në gjendje të kuptojë një gamë të gjerë tekstesh të ndërlikuara e të gjata e di të shpjegojë edhe domethënien e tyre. Di të shprehet në menyrë të rrjedhshme dhe spontane, pa mundim të madh për të gjetur fjalët. Është fleksibël me përdorimin e gjuhës në marrdhënie shoqërore, akademike e profesionale. Di të hartojë tekste të qarta, të strukturuar mirë me argumente komplekse, duke treguar kështu që është në gjendje të kontrollojë strukturën e bisedës, pikat kryesore dhe mekanizmat përbërëse të saj.</p>

C2 - I Përparuar i avancuar: Studenti është në gjendje të kuptojë pa u sforcuar, praktikisht çdo gjë që dëgjon apo lexon. Di të bëjë një përmbledhje të informacioneve të marra nga burime të ndryshme, të dëgjuara apo të shkruara duke ristrukturuar në një tekst të qartë argumentat dhe informacionet. Shprehet në mënyrë spontane, mjaft rrjedhshëm dhe saktë dhe di të shpjegojë mirë nuancat e duhura të kuptimit të fjalëve edhe në situata mjaft komplekse.

Në fund të kursit do të lëshohet një **vërtetim frekuentimi** nëse keni kaluar testin përfundimtar dhe keni ndjekur rregullisht mësimet.

Kurset e reja të gjuhës të nivelit A2, B1 dhe B2 përfshijnë përgatitjen për **Certifikatën e njohjes së gjuhës italiane (CELI) 1, 2, 3.**